



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE  
DREJTORIA E PROKURIMEVE

**Drejtuar: Operatorit ekonomik “Besnik Meçi”**

**Adresa:** KASHAR, Autostrada Tiranë-Durrës, Km.5, Godine nje katëshe perballe QTU-së

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

**Procedura e prokurimit: “Kërkesë për propozim”** në mbështetje të ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” (i ndryshuar), neni 30 si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar) kreu IV, Neni 33.

**Referenca e procedures loti i dytë: REF-76979-10-28-2020**

**Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Pjesë këmbimi goma dhe bateri”, loti II: “Pjesë Këmbimi Bateri”.**

**Fondi limit: 1.551.453** (një milion e pesëqind e pesëdhjetë e një mijë e katërqind e pesëdhjetë e tre) **lekë pa tvsh.**

**Afati për realizimin e furnizimit:** Operatori fitues duhet të lëvrojë mallin sipas kërkesave dhe specifikimeve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor brenda 30 ditëve pune nga data e lidhjes së kontratës. Malli duhet të dorëzohet në magazinën e Bashkisë Tiranë.

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 09.11.2020**

Publikime të mëparshme, (nëse zbatohet): Buletini Nr. 94 datë 2 Nëntor 2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë ofertuesit ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara si më poshtë-

**1. Operatori ekonomik “Besnik Meçi” Pf,**

**NIPT L12407012R**

Vlera e ofertes pa tvsh: **1.397.500** (një milion e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lek

## 2. Operatori ekonomik “Alked Kopaçi” person fizik, NIPT K41510041C

Vlera e ofertes 0 (zero) lekë

## 3. Operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” sh.p.k, NIPT L62311016C

Vlera e ofertes pa tvsh: 1,445,700 (një milion e katërqind e dyzetë e pesë mijë e shtatëqind) lekë

Është s’kualifikuar

- **Operatori ekonomik “Alked Kopaçi” person fizik për arsyet si më poshtë vijon:**

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se Operatori ekonomik “Alked Kopaçi” person fizik nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar tek kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “Alked Kopaçi” person fizik s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik "Besnik Meçi"pf** me adresë: KASHAR, Autostrada Tiranë-Durrës, Km.5, Godine nje katëshe perballe QTU-së, oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **1.397.500** (një milion e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranës sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet sic parashikon Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 13.11.2020.**

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”( i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.

